

VENDIM
Nr.481, datë 16.7.2004

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË PUKËS TË MJEDISEVE TË ISH-HOTELIT TË USHTARAKËVE DHE TË ISH-DEGËS SË MOBILIZIMIT NË PUKË, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit, në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli të Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-hotelit të ushtarakëve dhe të ish-degës së mobilizimit në qytetin Pukë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të bashkisë së Pukës, për t’u përdorur për interesa publike në shërbim të komunitetit të këtij qyteti.

2. Pronat me numrat rendorë 532, “Ish-hoteli i ushtarakëve” dhe nr.535 “Ish-dega e mobilizimit” në qytetin e Pukës, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Pukës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, t’i tjetërsojë ose t’ua japë përdorim të tretëve, pa miratimin e pushtetit qendror.

4. Ngakohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Pukës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano